

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT

"Prodhim mobiljesh dhe perpunim te lendeve
drusore"



Subjekti : “ RO -AL” sh.p.k
Hartoi: “EKO-STUDIO-PROJEKT”sh.p.k
Administrator : Shkelzen MADANI

Tirane 2018

PERMBAJTJA

+ Hyrje

+ Baza ligjore

+ Metodika e vleresimit te mjedisit

+ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Prodhim mobiljesh dhe perpunim te lendeve drusore ”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te*

hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

➤ **Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se**

Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jape nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti: “ **RO -AL**” **sh.p.k**” shpk,eshte regjistruar ne QKB me nr NIPT : J61811001M ,ne date 23/01/1995 me perfaqesues ligjor **Z. Robert Kaso**. Ky subjekt ushtron aktivitetin“ Prodhim mobiljesh dhe perpunim te lendeve drusore”.Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B .

Pershkrimi i projektit

" **RO -AL** " sh.p.k ofron per konsumatorët karrige, tavolina dhe mobilje me nje dizajn estetik, modern dhe elegant, qe ngacmojne deshiren per te blere. Shumellojshmeria dhe koncepti i diferencuar qarte i mobilimit, sigurojne pelqimin e konsumatorit ne nje shkalle te gjere. Cilesia e produkteve perberese te mobiljeve, e perzgjedhur nga specialiste me pervojë shumevjecare ne kete fushe, e bejne " **RO -AL** " sh.p.k, me te kerkuarat sot ne tregun e mobilimit.

Aktiviteti zhvillohet eshte i ndare ne kete menyre:

- Reparti i prodhimit te elementeve per karriget
- Reparti i prodhimit te elementeve per tavolinat, mobiljet
- Reparti i montimit
- Reparti i bojatisjes
- Reparti i tapicerise
- Magazina
- Ekspozita



A. Lenda e pare drusore kalon ne proceset qe do ti sqarojme me poshte

B. Lendet ndihmese te cilat do sqarojme me poshte.

1. Lenda e pare drusore Ah qe ne perdorim per prodhimin e karriges kalon ne keto procese dhe ne kemi keto rrezultate:
 - Trupat e Ahut kalojne ne procesin e sharrimit ne makinën Gater Sharre Shirit dhe pas prerjes ne kemi:
 - a-derrase te permasave 25 mm, 30 mm, 45 mm dhe 50 mm ne vleren 60-65%
 - b-anie ne vleren 25-30% ku 50% e sasise shkon per shitje si dru zjarri dhe 50% eshte humbje
 - c- tallazh ne vleren 10-15% ku rreth 40% shkon ne sillor dhe shitet per te trete
2. Procesi vijues eshte stivosja ne parametrat e duhur per te kaluar ne tharrje natyrale
3. Pas procesit te tharrjes derrasa kalon ne makine multilame ku perfitojme:
 - Element te permasave te ndryshem sipas derrases dhe kerkeses kjo ne vleren 70-75%
 - Anie dhe copa derrasash ne vleren 20-25% nga kjo 75-80% shkon per dru zjarri dhe shitet dhe 20-25% product I pa perdoreshm

- Tallazh ne vleren 5-10% ku 70% shkon ne sillor dhe shitet
4. Procesi vijues eshte procesi I prejes ne pendul vertical te elementeve ne permasat gjatesore duke perfituar elementet grexo sipas skicave bashke ngjitur, gjate ketij procesi kemi keto rezultate:
- Element ne vleren 80-85% te lendes
 - Mbetje drusore ne vleren 10-15%, nga e cila 80% shkon per dru zjarri dhe 20% mbetje te pa vlere
 - Tallazh ne vleren 5-10% nga I cili 50% shkon ne sillor per tu shitur dhe 50% mbetje pa vlere
5. Procesi vijues per pjesen kryesore te lementeve qe perdoren ne prodhimin e krriges eshte kalimi ne makinën Skoniatrice ku cdo element grexo kalon ne product gjysem I gatshem. Ne kete process secili element kalon me vete.(kember e pasme, kember para, lidhese sedilje dhe lidhese kember)
- Ne kete process kemi dhe gjithashtu sasite do te jene te paraqitura ne tabelat bashkangjitur.
- Elementin gjysem te gatshem
 - Mbetje drusore
 - Tallazh
- Trekendeshat kalojne ne makinën freze dhe ne perfundim kemi:
- Trekendesha (sipas Skemesh)
 - Tallazh
6. Procesi I shpimit te kemberve para dhe pas dhe ne tabelen bashkangjitur do te pasqyrojme vlerat pasi kemi ne perfundim:
- Kember para ose pas
 - Tallazh
7. Procesi I berjes se thithave te lidhese te sediljes ne makinën e thithave, dhe ne tabelen perkatese do te paqyrojme vlerat pasi ne perfundim kemi:
- Elementin e lidheseve e sediljeve
 - Tallazh
8. Procesi I montimit te karriges ku kemi tre makineri, dy presa hidraulike dhe nje makine nxiinglimi dhe ne perfundim te ketij procesi kemi karrigen grexo.(ketu perdorim kember e pasme 2 cope, kember e para 2 cope, lidhese sedilje 4 cope, lidhese kember 4 cope, trekendesha 4 cope, spalier te gatshme dhe ngjitesh)
9. Procesi I magazinimit

10. Procesi I lyerjes , ku gjate ketij procesi per dorim keto makineri kazan lyerje ose lyerje me pistolet ne dhomen e lyerjes, transportues ajeror, leviguse, dhomen e lyerjes per lyerjen me paste, tranportusin per tharrje, levigim, lyerjen me llak ne dhomen e lyerjes dhe transportusin per tharrjen perfundimtare.(gjate ketij procesi perdoret boje, diluent, uje, rezine, katalit, paste, llak dhe leter zmerilimi)
 11. Process vijues eshte procesi I prodhimit te sediljes I cili kryhet I gjithi me produkte gjysem te gatshem. Baza e sedilje melamine e cila pritet ne permasen e duhur, sfungjer, cope per veshjen e sedilies , beze per pjesen poshte dhe thumba) makinerite ne te cilat kalon procesi iprodhimit te sedilies jane: sharra per prejen e sedilies, presat per montimin dhe pistoleta per thumbat.
 12. Procesi I montimit te sedilies dhe nivelimit te karriges, perdoret trapan dore dhe disk horizontal per nivelim.
Procesi perfundimtar eshte procesi I ambllazhimit ku perdoren sipas kerkesave, qese, karton ose veshje me plastik.
- 1- Materiali baze (MDF me lyerje) priten ne makinerine Sharre Vertikale ose Horizontale ku ne perfundim te ketij proces prerje, perfitojme:
 - a. Material per prodhim me permasat e duhura ne 90 - 95% te sasise
 - b. Mbetje 5 – 8 % te sasise
 - c. Tallash 0 – 2 % te sasise
 - 2- Freze shpimi (birat per menteshat dhe bravat)
Gjate ketij procesi kemi shpimin e elementeve per vendosjen e elementeve ndihmes sic jane: menteshat, bravat, dhe element te tjere ndihmes.
 - a. Materiali mbetet ne vleren 100%
 - b. Mbetje 0 - 1% te sasise dhe eshte Tallash
 - 3- Lyerja
Gjate ketij procesi kemi disa procese te nderlidhura me njeri-tjetrin te cilat po i rendisim me poshte:
 - Levigim me makineri leviguese
 - Boja baze e cila kryhet me lyerje me pistolette elektrostatische.
 - Tharrja e cila kryhet me sistemim ne dhomen e tharjes
 - Lyerje me paste e cila kryhet ne dhomen e lyerjes me pistolette elektrostatische
 - Tharrja e cila kryhet me sistemim ne dhomen e tharjes
 - Levigimi me leviguse ose me dore te lire
 - Lyerja me llak dhoma e lyerjes me pistolette elektrostatische
 - Tharrja e cila kryhet me sistemim ne dhomen e tharjes
 - 4- Procesi I montimit.
Ky proces kryhet me vegla dore si trapano, vidator, sege, morsa, kacavida etj.
 - a. Materiali mbetet ne vleren 100%
 - 5- Ambllazhimi i produktit ne makinerine perkatese,
 - 6- Magazinimi.

1. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita Gjeografike

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrez të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Qendrën e Tiranës e përshkon përroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm.

Kushtet klimatike

Ajri është me lagështi mesatare 60-80%. Përsa i përket cilësisë së ajrit ai konsiderohet jo shumë i ndotur pasi zona nuk është zonë industriale që të prodhojë gaze ndotëse për ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetëm nga pluhurat që krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitete të tjera njëzore. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.

Tirana ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësiat dhe pozicioni i vendit të matjes. Intensiteti i rrezatimit të drejtpërdrejtë i diellit është më i lartë në muajin Maj, ndërsa më i ulët në Dhjetor. Kurse vlera më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik. Reshjet në Tirane kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut, që kapin shifrën 128 –139 ditë reshje në vit. Lagështia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Tirana ka një thatësi të zgjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Tirana - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Temp. Maks. (°C)	12	12	15	18	23	28	31	31	27	23	17	14	Ø 20,9
Temp. Mini. (°C)	-8	-8	-4	-1	3	6	11	10	5	1	-3	-7	Ø 0,4
Reshje (mm)	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	Σ 1.353

Era

Eshte një element shumë i ndryshueshem nga një zonë në një tjetër për shkak të ndikimit të madh që relievi ka mbi të. Megjithatë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike të zonës dhe relievit përreth, erërat nuk karakterizohen nga një shpejtesi e madhe . Erërat mbizotëruese janë kryesisht lindore dhe juglindore dhe ndonjëherë ka erëra te nxehta .

Lagështia

Zona ne fjale eshte e karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë i lagështisë, me një vlerë vjetore mesatare prej 73%. Vlera më e ulët është vërejtur në korrik me 67% dhe më të lartë në dhjetor me 76%.

Toka/Flora/Fauna

Tokat ne kete zone jane ngjyre hiri, kafe qe shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesite me te medha te zones. Ky ekosistem perfaqesohet nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga druret frutore qe jane mjaft te perhapur ne kete rajon. Toka e zones nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson siperfaqe te shfrytezueshme si kullote.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- **Territori perreth objektit**

I gjithe territori i objektit dhe rruga hyrese ne te eshte e shtruar dhe e sistemuar. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth aktivitetit duke bere te mundur mbjelljen me peme dhe lule.

- **Emetimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere sepse te gjitha makinerite punojne me energji elektrike e cila eshte nje burim i paster energjie, por ka vetem pluhur nga druri qe perpunohen. Per te minimizuar kete ndikim negativ ne repart eshte vendosur nje sistem i thithjes se pluhurave.

- **Mbetjet e ngurta**

Mbetjet e ngurta qe krijohen nga procesi i punes, kryesisht copa derrasash te vogla mbidhen dhe perpunohen. Mbetjet e tallashit, largohen nga firma te interesuara, pasi ai perdoret ne pulari. Tallashi largohet cdo 2-3 dite nga subjekti.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret ne nje sasi te vogel per nevoja te mbrojtjes kundra zjarrit apo per sherbime higjieno-sanitare. Keto ujera jane brenda normave te lejuara perpara se te shkarkohen ne mjedisin uhor prites.

- **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga makinerite brenda ambienteve te punes, por nga drejtuesit e shoqerise jane marre masa per te pajisur punetoret me paisjet e mbrojtjes nga zhurmat (kufje).

Ne perimetrin e jashtem zhurmat jane ne parametrat dhe ne normat e lejuara dhe nuk perbejne problem shqetesues.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata jane te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Ata perdorin maska gjate proceseve te punes, ne menyre qe ajri me pluhur te pastrohet para se te thithet nga organizmi. Po keshtu gjate procesit te lysterjes tregohet nje kujdes i vecante ne menyre qe te mos ndotet ambjenti por dhe te ruhen punonjesit nga ererat dhe elementet e tjere kimike te bojerave qe perdoren per lysterje.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e shoqerise jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e fabrikes jane vendosur ne vende te dukshme pajisje te mbrojtjes nga zjarri dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

- **Territori perreth objektit**

I gjithë territori i objektit dhe rruga hyrese ne te eshte e shtruar dhe e sistemuar. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth aktivitetit duke bere te mundur mbjelljen me peme dhe lule.

- **Masat per emetimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere sepse te gjitha makinerite punojne me energji elektrike e cila eshte nje burim i paster energjie, por ka vetem pluhur nga druri qe perpunohen. Per te minimizuar kete ndikim negativ ne repart eshte vendosur nje sistem i thithjes se pluhurave.

- **Mbetjet e ngurta**

Mbetjet e ngurta qe krijohen nga procesi i punes, kryesisht copa derrasash te vogla mbidhen dhe perpunohen. Mbetjet e tallashit, largohen nga firma te interesuara, pasi ai perdoret ne pulari. Tallashi largohet cdo 2-3 dite nga subjekti.

- **Masat per shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret ne nje sasi te vogel per nevoja te mbrojtjes kundra zjarrit apo per sherbime higjieno-sanitare. Keto ujera jane brenda normave te lejuara perpara se te shkarkohen ne mjedisin ujqor prites.

- **Masat per zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga makinerite brenda ambienteve te punes, por nga drejtuesit e shoqerise jane marre masa per te pajisur punetoret me paisjet e mbrojtjes nga zhurmat (kufje). Ne perimetrin e jashtem zhurmat jane ne parametrat dhe ne normat e lejuara dhe nuk perbejne problem shqetesues.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata jane te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Ata perdorin maska gjate proceseve te punes, ne menyre qe ajri me pluhur te pastrohet para se te thithet nga organizmi. Po keshtu gjate procesit te lyerjes tregohet nje kujdes i vecante ne menyre qe te mos ndotet ambjenti por dhe te ruhen punonjesit nga ererat dhe elementet e tjere kimike te bojerave qe perdoren per lyerje.

- **Masat per mbrojtjen nga zjarri**

Nga ana e shoqerise jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e fabrikes jane vendosur ne vende te dukshme pajisje te mbrojtjes nga zjarri dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

- Ky aktivitet ne procesin e prodhimit nuk perdor lende te demshme te ngurta apo te lengeta qe shkarkohen ne ambient dhe qe mund te demtojne mjedisin.

- Teknologjia e perdorur gjate proceseve te punes eshte e perparuar dhe sipas standarteve te Bashkimit Evropian.
- Ky aktivitet nuk ka ndikim negativ ne popullsi, nuk prek zona te mbrojtura, objekte te rendesise se vecante.
- Gjate aktivitetit nuk ka ndotje te tokes, ujerave dhe ajrit.
- Per nje siguri maksimale në impiant zbatohen, ne menyre te perpikite, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes kunder zjarrit.
- Aktiviteti. nuk ka efekte anesore ne mjedis dhe me masat e marra nuk ka premisa qe te sjelle ndotje mjedisit apo pasoja negative per shendetin e njerezve te flores dhe faunes.

Rekomandime

Duke ditur se gjate proceseve te punes çlirohen në mjedis zhurma te makinerive, vibrim në afersi të makinerve për të rritur sigurinë në punë dhe cilesinë e jetës së punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

- Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtese nga zjarri dhe zbatimi i rregullave ne te gjithe teritorin. Te merren masa per te patur ne gadishmeri te plote dhe te kolauduara mjetet e mbrojtjes nga zjarri.
- Te hartohet nje plan i detajuar i mbrojtjes nga zjarri, me detyrat e percaktuara per te gjithe punonjesit dhe te njihen punonjesit periodikisht me detyrat qe kane ne raste emergjencash.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, me masat dhe per mbrojtjen nga zjarri. Punonjesit periodikisht te njihen me efektet e zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të ambjenteve te punes.